



VITI I HUMBUR LEGJISLATIV



Kosova po e mbyll vitin kalendarik me reforma të ngrira dhe kërkesa të paadresuara të shoqërisë civile. Me Kuvend të pakonstituiuar për pjesën më të madhe të vitit dhe me Qeveri në detyrë, ligje të rëndësishme nuk u miratuan. Çfarë u humb në aspektin legjislativ në vitin 2025 dhe çfarë pasojash mund të sjellë kjo paralizë institucionale?

**KURTI:
NORMALIZIMI
I RAPORTEVE
ME SERBINË,
SHUMË
I VËSHTIRË** F. 3



**OSBE-ja:
BASHKËPUNIMI
NDËR-KOMUNAL
ËSHTË NJË MJET
I FUQISHËM,
POR PAK I
SHFRYTËZUAR** F. 7



AKTUALE



- ZELENSKY SHPALOS NJË PLAN
20-PIKËSH PËR PAQE** F. 2
- LIDERËT UROJNË KRISHTLINDJET**
F. 5
- SHQIPËRIA PAJISJET ME SISTEMIN
AMERIKAN JAVELIN** F. 3
- NDËRPRITET SEANCA PËR
SHPËRTHIMIN NË IBËR-LEPENC,
MBROJTJA KËRKON PËRJASHTIMIN
E PROKURORIT** F. 6

EKONOMI



- Reagim nga KMDLNj
- FATURAT KRIMINALE TË RRYMËS
PËR MUAJIN DHJETOR** F. 8
 - UP-JA ORGANIZON PROGRAMIN
'TRAIN-THE-TRAINER' PËR
KËSHILLIMIN DHE NDËRMJETËSIMIN
NË TREGUN E PUNËS** F. 8

SPORT



**FIFA: KOSOVA, KOMBËTARJA ME
NGJITJEN MË TË MADHE NË
RANGLISTË GJATË VITIT 2025** F. 11

RENOVA
PUTZ

Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

**PRINCESHA**
GROUP SH.PK.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**
FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**INFINITY**
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

ZELENSKY SHPALOS NJË PLAN 20-PIKËSH PËR PAQE

KIEV, 24 DHJETOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, e ka shpalosur variantin më të fundit për një marrëveshje paqeje, e ndërmjetësuar nga Shtetet e Bashkuara, e cila synon t'i japë fund luftës pothuajse katërvjeçare të Rusisë kundër Ukrainës.

Duke i njoftuar gazetarët më 23 dhjetor, Zelensky paraqiti një plan me 20 pika, i përpiluar gjatë javëve të fundit nga negociatorë nga Shtetet e Bashkuara, Ukraina dhe vendet evropiane.

Drafti thekson një marrëveshje të plotë dhe të pakushtëzuar "joagresore" midis Rusisë dhe Ukrainës, megjithëse çështje të pazgjidhura, si kontrolli territorial mbi Ukrainën lindore dhe fati i centralit bërthamor të Zaporizhjas - objekti më i madh i energjisë bërthamore në Evropë - mbeten ende të ndërlikuara.

Kremlini deklaroi se presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, ishte njoftuar me draftin dhe se Moska tani po përgatit përgjigjen e saj. "Ky është një dokument që quhet kornizë, një dokument themelor për përfundimin e luftës, një

dokument politik mes nesh, Amerikës, Evropës dhe rusëve", tha Zelensky. "Ne jemi të gatshëm për një takim me Shtetet e Bashkuara në nivelin e liderëve për të shtjelluar çështje të ndjeshme. Çështje si ajo e territoreve duhet të diskutohen në nivelin e liderëve".

Garanci e sigurisë për Ukrainën Drafti parashikon garanci të forta sigurie për Ukrainën, përfshirë ruajtjen e numrit të personelit të Forcave të Armatosura të Ukrainës në 800.000 edhe në kohë paqeje.

Ai gjithashtu parashikon që Shtetet e Bashkuara, NATO-ja dhe shtetet nënshkruese evropiane, t'i ofrojnë Ukrainës garanci sigurie që pasqyrojnë Nenin 5, një element qendror i strukturës së aleancës, sipas të cilit një sulm ndaj një anëtarë konsiderohet sulm ndaj të gjithë anëtarëve.

Marrëveshja do të plotësohet me marrëveshje dypalëshe SHBA-Ukrainë për sigurinë dhe rindërtimin, dhe Ukrainës do t'i lejohej anëtarësimi në Bashkimin Evropian brenda një afati kohor të përcaktuar qartë, thuhet në plan.

Putini ka theksuar se fundmi se



Ukraina duhet t'ia dorëzojë Rusisë rreth 5.000 kilometra katrorë të rajonit lindor të Donbasit, të cilin Moska po përpiket ta marrë me forcë, dhe se Kievi duhet të heqë dorë zyrtarisht nga synimi për t'u anëtarësuar në aleancën ushtarake të NATO-s. "Vija e vendosjes së trupave në datën e kësaj marrëveshjeje njihet de facto si vija e kontaktit", tha Zelensky.

"Një grup pune do të mblidhet për të përcaktuar rivendosjen e forcave të nevojshme për t'i dhënë fund konfliktit, si dhe për të përcaktuar parametrat e zonave të mundshme të veçanta ekonomike në të ardhmen".

Një diplomat i NATO-s i tha Radios Evropa e Lirë se garancitë e sigurisë dhe zgjidhja e çështjeve territoriale janë "thelbi i problemit". "Mendoj se gjëja më e rëndësishme për ne është që Ukraina ta miratojë marrëveshjen. Siç u tha më herët, evropianët nuk do të mbështesin një marrëveshje pa miratimin e Ukrainës", shtoi diplomati, i cili kërkoi të mbetet anonim.

Çështjet e ndërlikuara

Zelensky tha se do të krijohet një mekanizëm për ta kontrolluar vijën e kontaktit përmes vëzhgimit të

palëvizshëm nga hapësira, si dhe për të siguruar njoftim të hershëm për shkeljet.

Pikat kryesore që mbeten të pazgjidhura, sipas tij, përfshijnë fatin e centralit bërthamor të Zaporizhjas, i cili ndodhet në territor nën kontroll ushtarak rus pranë vijës së frontit.

Sipas draftit të planit të paqes, centrali do të udhëhiqej bashkërisht nga Ukraina, Shtetet e Bashkuara dhe Rusia.

Zelensky ka treguar gjithashtu se një referendum për marrëveshjen e paqes dhe zgjedhjet presidenciale mund të mbahet njëkohësisht, dhe se çdo garanci sigurie do të hynte në fuqi vetëm pasi marrëveshja të ratifikohet plotësisht ose të miratohet përmes referendumit.

"Ukraina do ta paraqesë këtë marrëveshje në Parlament për ratifikim dhe/ose do të mbajë një referendum mbarëkombëtar për miratim në formatin 'po' ose 'jo'", u tha Zelensky gazetarëve.

Draft-marrëveshja përfshin gjithashtu një dispozitë sipas së cilës të gjithë civilët e ndaluar dhe pengjet, përfshirë fëmijët dhe të burgosurit politikë, do të kthehen.

RAPORTI PËR SHQIPËRINË, FMN: 'PAQJA FISKALE' MINON PROGRESIN NË ADMINISTRIMIN TATIMOR, RREZIKOHET QËNDRUESHMËRIA FISKALE



TIRANË, 24 DHJETOR - Fondi Monetar Ndërkombëtar ka publikuar raportin për Shqipërinë. Në raport thuhet se vendi ynë vazhdon të shënojë rritje të fortë ekonomike, e nxitur kryesisht nga turizmi dhe konsumi privat, me PBB-në reale që pritet të rritet 3.5% në vitin 2025 dhe 3.6% në 2026. Inflacioni mbetet i ulët, borxhi publik po ulet dhe rezervat

valutore qëndrojnë të forta, duke krijuar një bazë solide për reformat e qeverisë dhe synimin për anëtarësimin në BE deri në vitin 2030.

Megjithatë, Fondi Monetar Ndërkombëtar paralajmëron se marrëveshja e quajtur "Paqja Fiskale" mund të minojë progresin e mëparshëm në administrimin dhe pajtueshmërinë tatimore, duke

rrezikuar qëndrueshmërinë fiskale në mes të sfidave demografike dhe shpenzimeve publike në rritje.

FMN nënvizon gjithashtu rëndësinë e reformave strukturore në kapitalin njerëzor, tregun e punës dhe qeverisje për të ruajtur stabilitetin makroekonomik dhe për të nxitur konvergencën me standardet e BE-së.

RUSIA SYNON TË NDËRTOJË NJË CENTRAL BËRTHAMOR NË HËNË

MOSKË, 24 DHJETOR - Rusia planifikon të ndërtojë një central bërthamor në Hënë në dekadën e ardhshme për të furnizuar programin e saj hapësinor hënor dhe një stacion të përbashkët kërkimor ruso-kinez, teksa fuqitë e mëdha po nxitojnë të eksplorojnë satelitin e vetëm natyror të Tokës.

Që nga koha kur kozmonauti sovjetik, Yuri Gagarin, u bë

njeriu i parë që shkoi në hapësirë më 1961, Rusia e ka paraqitur veten si një fuqi udhëheqëse në eksplorimin e hapësirës, por në dekadat e fundit ka mbetur prapa Shteteve të Bashkuara në këtë drejtim, dhe gjithnjë më prapa edhe Kinës.

Ambiciet e Rusisë pësuan një goditje të madhe në gusht të vitit 2023, kur misioni i saj pa ekuipazh Luna-25 u përplas

me sipërfaqen e Hënës gjatë përpjekjes për t'u ulur, teksa miliarderi Elon Musk ka revolucionarizuar lëshimin e mjeteve hapësinore, gjë që dikur ishte një specialitet rus.

Korporata shtetërore ruse e hapësirës, Roscosmos, njoftoi se planifikon të ndërtojë një central energjetik në Hënë deri në vitin 2036, duke shtuar se ka nënshkruar një kontratë me

kompaninë e industrisë hapësinore, Lavochkin Association për ta realizuar këtë projekt.

Roscosmos tha se qëllimi i centralit është që të furnizojë me energji programin hënor të Rusisë, përfshirë automjetet robotike, një observator dhe infrastrukturën e Stacionit e Përbashkët Ndërkombëtar Kërkimor Ruso-Kinez.



Shqipëria pajisjet me sistemin amerikan Javelin

TIRANË, 24 DHJETOR - Shqipëria ka pranuar dërgesën e parë me sistemin kundëtanke Javelin nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bëri të ditur Ministria e Mbrojtjes. Sipas ministrit shqiptar të Mbrojtjes, Pirro Vengu, pajisja e Forcave të Armatosura të Shqipërisë me këtë sistem përbën një hap të rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve mbrojtëse dhe përmbushjen e synimit për modernizimin e ushtrisë.

“Ardhja e sistemeve Javelin, falë bashkëpunimit me aleaten tonë strategjike ShBA-në, forcon

aftësitë mbrojtëse të Forcave të Armatosura Shqiptare, rrit parandalimin, ndërveprueshmërinë me NATO-n dhe sigurinë kombëtare”, tha Vengu.

Ai shtoi se dërgesa e dytë do të arrijë në Shqipëri gjatë vitit 2026. Shqipëria, anëtare e NATO-s, i ka porositur këto sisteme në kuadër të programeve të bashkëpunimit ushtarak me ShBA-në, përmes mekanizmave të shitjeve ushtarake të huaja.

“Ky investim është pjesë e strategjisë afatgjatë të modernizimit të Forcave të Armatosura, rritjes së

parandalimit dhe përafrimit të plotë me kapacitetet dhe doktrinën e NATO-s”, u tha në njoftim.

Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë tha se ky sistem është i gjeneratës së fundit, që prodhohet në ShBA dhe konsiderohet kyç për mbrojtjen tokësore.

Edhe Kosova ka porositur 200 sisteme Javelin. Blerja e tyre pritet t’i kushtojë Kosovës 75 milionë dollarë, teksa vendi është në proces të transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri.



Përveç këtyre sistemeve, autoblanda dhe pajisje të tjera nga ShBA-ja dhe nga shtete të tjera.

KURTI: NORMALIZIMI I RAPORTEVE ME SERBINË, SHUMË I VËSHTIRË

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Kosova dhe Serbia duhet t’i “normalizojnë” raportet mes vete, tha kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, në një intervistë për AFP-në, disa ditë para mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Megjithatë, ai tha se ky proces është i vështirë.

Kurti është në pushtet që nga viti 2021 dhe dy vjet pasi mori pushtetin, arriti Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të raporteve dhe Aneksin e zbatimit të saj, por marrëveshja ende nuk është zbatuar. “Ne duhet t’i normalizojmë raportet me Serbinë”, tha Kurti.

“Por, normalizimi i raporteve me një fqinj që ka regjim autoritar dhe që nuk të njeh, dhe po ashtu nuk i pranon krimet e kryera gjatë luftës, është shumë i vështirë”, shtoi ai.

Tensionet mes dy vendeve vazhdimisht janë të larta dhe një rikthim i trazirave do t’i ofronte Rusisë mjete për ta destabilizuar Kosovën. “Ne kemi një marrëveshje për normalizim”, tha Kurti duke iu referuar marrëveshjes së vitit 2023, të arritur nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. “Ne duhet ta zbatojmë, që nënkupton njohje të ndërsjellë mes shteteve, të paktën njohje de facto”.

Kjo marrëveshje, me 11 nene, veç tjerash parasheh një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë,



njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, që Serbia të mos bllokojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, dhe kërkon nga Prishtina dhe Beogradi që t’i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut.

Por, për të rinisur dialogu, Serbia “duhet ta dorëzojë Millan Radoiçiqin”, tha Kurti, duke iu referuar ish-nënkryetarit të Listës Serbe, i cili ka marrë përgjegjësinë për sulmin e armatosur ndaj Policisë së

Kosovës në Banjskë më 2023.

Kurti tha se shpreson që “BE-ja, Franca dhe Gjermania do t’i bëjnë presion” Serbisë që ta dorëzojë Radoiçiqin, ndaj të cilit dhe disa personave të tjerë Kosova ka ngritur aktakuzë për sulmin në Banjskë.

Që nga shtatori i vitit 2023, disa ditë para sulmit të armatosur në Banjskë, nuk është mbajtur asnjë rund i nivelit të lartë në Bruksel, teksa bisedimet në nivel kryenegociatorësh kanë vazhduar, por nuk kanë prodhuar ndonjë marrëveshje.

Serbia po ashtu nuk ka ndërprerë raportet me Rusinë, pavarësisht luftës në Ukrainë, dhe Beogradi varet nga energjia ruse. “Ka shumë lidhje” mes dy shteteve, tha Kurti, dhe nëse Rusia vendos ta destabilizojë rajonin, “në marshin e saj drejt Evropës Perëndimore, mund të llogarisë në Serbinë si aleat. Dhe, kjo është shqetësuese për shtetin tonë. Por, ne po punojmë me partnerët tanë për të parandaluar një gjë të tillë”.

Kosova, që shpreson t’i bashkohet NATO-s, së voni ka

hequr tarifat ndaj produkteve amerikane dhe është pajtuar që të pranojë deri në 50 migrantë nga shtetet e treta që do të dëbohen nga ShBA-ja. Deri më tani, në Kosovë ka arritur vetëm një migrant. “Nuk po kërkojmë asnjë ndihmë financiare në këmbim”, tha Kurti. “Ne po e bëjmë këtë për të ndihmuar ShBA-në, që është partnerja, aleatja dhe mikja jonë”, shtoi Kurti, i cili nuk e përjashtoi mundësinë e arritjeve të marrëveshjeve të ngjashme edhe me vendet evropiane.

Shpend Ahmetit i ngrihet aktakuzë për deklarin të pasaktë të pasurisë

Prishtinë, 24 dhjetor - Prokuroria Speciale ka njoftuar se ka ngritur aktakuzë ndaj ish-kryetarit të Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmetit, për mosraportim apo raportim

të rreme të pasurisë. Sipas aktakuzës, Ahmeti, i cili shërbeu si kryetar i Prishtinës për dy mandatë, nga viti 2013 deri më 2021 - kishte paraqitur “me dashje” deklarata të pasakta të

pasurisë, pasi thuhet se nuk kishte deklaruar deponimet në para të gatshme nga 2018 deri në vitin 2022. “Sipas aktakuzës, shumat e përgjithshme e mjeteve të padeklaruara arrin vlerën

prej 172,600.00 euro”, thuhet në njoftimin e Prokurorisë Speciale, që bëri të ditur se rasti tashmë është dërguar për shqyrtim Gjykatës Themelore në Prishtinë.





VITI I HUMBUR LEGJISLATIV

Kosova po e mbyll vitin kalendarik me reforma të ngrira dhe kërkesa të paadresuara të shoqërisë civile. Me Kuvend të pakonstituar për pjesën më të madhe të vitit dhe me Qeveri në detyrë, ligje të rëndësishme nuk u miratuan. Çfarë u humb në aspektin legjislativ në vitin 2025 dhe çfarë pasojash mund të sjellë kjo paralizë institucionale?

PRISHTINË, 24 DHJETOR - E enjta e 5 dhjetorit 2024 solli seancën e fundit të legjislaturës së tetë të Kuvendit të Kosovës.

Para zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit të këtij viti, kjo legjislaturë u shpërnda dhe 18 ligjet e miratuara të asaj dite mbeten të fundit edhe tani kur po mbyllet viti 2025. Kjo, pasi që deputetët e dalë nga zgjedhjet e shkurtit nuk arritën as ta konstituojnë Kuvendin deri në gjysmë të tetorit.

Përveç 60 takimeve në sallën e Kuvendit të Kosovës për konstituim, këta deputetë u mblodhën vetëm edhe tri herë. Dy herë - më 26 tetor dhe 19 nëntor - për të votuar propozimet e mandatarëve për kryeministër; dhe një herë, më 19 nëntor, për një seancë të jashtëzakonshme për buxhet.

Deputetët e dalë nga zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit u takuan 63 herë në sallën e Kuvendit të Kosovës. Megjithatë, në rreth 750 minutat punë, ata nuk arritën të zgjedhin një Qeveri të re apo ta miratojnë buxhetin. Madje, iu deshën 60 seanca për ta konstituar Kuvendin.

Dhe kështu, për një vit, asnjë ligj nuk u miratua, ashtu siç edhe do të pritej nga një qeveri në detyrë dhe një kuvend jofunksional. Por, rrethanat e 2025-tës nuk ishin

“normale”, thotë Naim Jakaj, nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD). “Do të duhej të trajtoheshin me urgjencë disa çështje jetike për funksionimin e shtetit”, thotë Jakaj për “Radion Evropa e Lirë”, duke përmendur marrëveshjet ndërkombëtare, ndarjet buxhetore për vitin 2026, buxhetin për Radiotelevizionin e Kosovës, si dhe buxhetin për katër komunat në veri të vendit.

Si një ndër “dështimet më serioze”, ai e cilëson moszbatimin e një aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese për pagat në sektorin publik, që ua mundësonte punonjësve, të cilëve u ishte ulur paga nga ligji i ri, të vazhdojnë të marrin shtesa transitorë derisa pagat e reja të barazohen me të vjetrat. “Kjo tregon se problem nuk ka qenë vetëm mungesa e institucioneve funksionale, por edhe mungesa e vullnetit për të respektuar rendin kushtetues dhe detyrimet ligjore”, thotë Jakaj. Gjatë vitit 2025, Qeveria në detyrë, e udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti, mbajti gjithsej 39 mbledhje.

Çka bëri Qeveria e Kosovës gjatë vitit 2025?

Nga 9 janari e deri më 19 dhjetor të këtij viti, Qeveria në detyrë e

Kosovës i mbajti 39 mbledhje. Në to u morën vendime për emërimë në poste të larta, shpronësime për projekte infrastrukturore, ndarje të mjeteve për bursat studentore, subvencione për familje në nevojë, mbështetje për projekte kulturore dhe sportive, si dhe masa të ndryshme buxhetore dhe financiare për institucione shtetërore.

Jakaj thotë se IKD-ja, gjatë monitorimit të saj, nuk ka vërejtur qasje proaktive dhe të qëndrueshme për të çuar përpara edhe procese të tjera të shumëpërfolura, si ai i vetingut në drejtësi dhe disa projektligje të tjera që tashmë kanë kaluar procesin e konsultimeve publike. Në mesin e tyre bëjnë pjesë: Projektligji për Akademinë e Drejtësisë, Projektligji për Rekrutimin, Vlerësimin e Performancës, Kontrollin e Integritetit dhe Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. “Mosshqyrtimi i këtyre nismave e ka bllokuar një hap të rëndësishëm drejt reformës së thellë në sistemin e drejtësisë”, thotë Jakaj, duke shtuar se një pjesë e madhe e përgjegjësisë bie mbi Lëvizjen Vetëvendosje, pasi që si parti në pushtet ka pasur kohë të zhvillojë “dialog politik transparent dhe substancial”.

Por, jo vetëm fusha e drejtësisë e ka pësuar nga kjo paralizë institucionale. Gjatë gjithë vitit, në temat e ndryshme që ka trajtuar “Radio Evropa e Lirë”, përgjigjet nga shoqëria civile, e madje edhe institucionet shtetërore, kanë përmendur se situata politike e ka pamundësuar adresimin e shumë nevojave. Për shembull, fondet e Planit të Rritjes të Bashkimit Evropian për

Kosovën, buxheti i Radio Televizionit të Kosovës, bordet gjysmake të shumë agjencive, Ligji për parandalimin e vetëvrasjeve, amendamenti i Kodit Penal ashtu që të përfshihet dhuna digjitale...

Marigona Shabiu, drejtoreshë ekzekutive e Iniciativës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - YIHR Kosova, thotë se viti 2025 ka shfaqur “mungesë totale të hapësirës për diskutim parlamentar mbi çështje thelbësore të të drejtave të njeriut, drejtësisë tranzicionale dhe sundimit të ligjit”. “Në mënyrë konkrete, nuk ka pasur as vullnet dhe as mundësi për t’u takuar me përfaqësues të Kuvendit, për të diskutuar rekomandimet e dala nga raporti i shoqërisë civile për vitin 2024, i cili adreson mangësi serioze në fushën e të drejtave të njeriut”, thotë Shabiu për “Radion Evropa e Lirë”.

Ajo thekson se, në këtë situatë, kërkesat e shoqërisë civile kanë mbetur jashtë agjendës publike dhe legjislative. Një prej më të rëndësishmeve, sipas saj, është trajtimi i draftit të Kodit Civil. “Mungesa e debatit parlamentar dhe e konsultimeve publike kuptimplota e ka lënë këtë proces të pezulluar, duke humbur një vit të tërë pa përparim ligjor”, thotë Shabiu.

Tutje, ajo thotë se jo vetëm që kërkesat e shoqërisë civile nuk janë adresuar, por se ajo dhe gazetarët janë përballur edhe me përpjekje të diskreditimit dhe delegjitimitit, “përfshirë përmes gjuhës denigruese dhe sulmeve publike, pa pasur reagim adekuat institucional apo mekanizma mbrojtës funksionalë”.

Disa herë në vitet e fundit, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës e ka kritikuar partinë në pushtet, Lëvizjen Vetëvendosje, dhe anëtarë të saj për gjuhën e

përdorur ndaj mediave.

Së voni, një ankesë të tillë e ka bërë edhe Bashkimi Evropian dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë. Jakaj shton se 2025-ta është edhe një vit tjetër në të cilin Kosova ka mbetur pa bërë hapa të mëdhenj në diplomaci të jashtme, si për shembull anëtarësim në Këshillin e Evropës. “Këto janë pasoja që e tejkalojnë një vit kalendarik dhe rrezikojnë të shndërrohen në probleme strukturore”, thotë ai.

Sipas tij, pasojat janë të dyanshme: politike dhe financiare. Për më tepër, as kompensimi për to, thotë Jakaj, nuk mund të jetë i shpejtë apo i lehtë.

“Realisht, do të duhen të paktën dy deri në tre vjet që të rikuperohet humbja e prodhuar nga mungesa e institucioneve funksionale gjatë vitit 2025. Disa procese mund të rifillojnë, por me kosto më të lartë politike, financiare dhe institucionale”, sqaron ai. “Rreziku kryesor është që një pjesë e reformave të humbasin momentumin dhe besueshmërinë, si brenda vendit, ashtu edhe në raport me partnerët ndërkombëtarë”, shton Jakaj.

Ai, po ashtu, thekson se viti i ardhshëm do të jetë vendimtar për ta përshpejtuar agjendën e reformave.

Kosova është fare pranë edhe një palë zgjedhjeve për këtë vit. Më 28 dhjetor do të mbahen zgjedhjet e parakohshme parlamentare, nga të cilat pritet të dalë legjislatura e dhjetë.

Por, Shabiu nga YIHR Kosova nuk është e bindur se, pas formimit të institucioneve të reja nga zgjedhjet e ardhshme, kërkesat e shoqërisë civile do të adresohen. “Aktualisht, vullneti politik mbetet i paqartë”, përfundon ajo.

Liderët urojnë Krishtlindjet

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka uruar të gjithë besimtarët e krishterë me rastin e Krishtlindjes, duke u dëshiruar paqe në shpirt, dashuri në familje dhe shëndet në çdo shtëpi. “Le të na bashkojë tradita jonë e respektit, solidaritetit dhe mikpritjes, duke na dhënë forcë të ecim përpara së bashku, me besim, shpresë dhe mirëkuptim. Gëzuar Krishtlindjen për shumë mot!”

ka shkruar Osmani në rrjetin social “Facebook”. Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka uruar Krishtlindjet, duke theksuar se janë koha kur reflektojmë, dhe mësojmë të jemi falënderues për çka kemi, të falim më shpejt dhe të duam më sinqerisht. “Ju uroj paqe, shëndet dhe mirësi! Gëzuar Krishtlindjet!”, ka shkruar në “Facebook” Haradinaj. Krishtlindja është një nga

kremtimet më të rëndësishme në kalendarin festave të krishtera, e cila festohet çdo datë 25 dhjetor për të kujtuar lindjen e Jezu Krishtit. Me rastin e kësaj feste, Ipeshkvia e Kosovës do të mbajë një organizim në Qendrën “BogdaniPolis” te Katedralja “Shën Nënë Tereza”, ku pritet të marrin pjesë përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, trupi diplomatik dhe njerëz të kulturës e artit.



KOSOVA DHE SHQIPËRIA DISKUTOJNË PËR RRITJEN E BASHKËPUNIMIT NË ARSIMIN USHTARAK

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**
PRISHTINË, 24 DHJETOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralëjtënant Bashkim Jashari, ka pritur në takim Shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë,

gjeneralëjtënant Arben Kingji. Fillimisht, gjeneral Jashari e falënderoi gjeneral Kingjin për lidhshirësinë e tij në udhëheqjen e FARSH-it, si dhe për mbështetjen dhe përkrahjen vëllazërore ndaj FSK-së. Po ashtu, u diskutuan zhvillimet aktuale në fushën e sigurisë dhe roli i FSK-së në garantimin e

sigurisë së Kosovës, si një kontribues i rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit rajonal. Gjatë takimit, të dy gjeneralët vlerësuan lart progresin e FSK-së në fushën e zhvillimit dhe modernizimit, si dhe performancën e trupave tona në ndërveprueshmëri gjatë aktiviteteve shumëkombëshe.

Njëkohësisht, u theksua rëndësia e mbështetjes së FARSH-it për zhvillimin e mëtejshëm të FSK-së, veçanërisht në fushat e arsimit, stërvitjes dhe shkëmbimit të përvojave, duke avancuar edhe më tej bashkëpunimin dypalësh. Në përfundim të takimit, gjeneralët ritheksuan se thellimi i

bashkëpunimit ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës mbetet një prioritet strategjik kombëtar. Në këtë kontekst, forcimi i kapaciteteve mbrojtëse u vlerësua si thelbësor për garantimin e sigurisë dhe stabilitetit rajonal.



Pasaportat më të fuqishme në botë, e Kosovës ngritët për disa vende krahasuar me vitin e kaluar

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Indeksi i Pasaportave Henley, një nga disa renditje që matin fuqinë e pasaportave, atë të Kosovës e rendit në vendin e 62 në botë. Kosovarët mund të udhëtojnë me të, pa vizë, në 81 vende. Pasaporta kosovare ka shënuar ngritje për disa

vende në krahasim me vitin 2024, kur ndodhej në vendin e 68-të. Nga pasaportat e shteteve të rajonit, Kroacia është ngjitur në vendin e shtatë në pasaportat më të fuqishme në botë, sipas përditësimit të fundit të Indeksit të Pasaportave Henley nga

dhjetori. Me 184 pikë, Kroacia është në të njëjtin grup me vende të tilla si Mbretëria e Bashkuar, Australia dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, duke e vendosur atë në një rreth të ngushtë vendesh me një nivel shumë të lartë të lëvizshmërisë ndërkombëtare.

Në vendin e parë, me 193 pikë, është ende Singapori, i cili e ka mbajtur fronin për vite me radhë falë lidhjeve të forta diplomatike dhe fuqisë ekonomike, e cila u lejon mbajtësve të pasaportave të tij qasje në pothuajse të gjithë botën pa vizë.



NDËRPRITET SEANCA PËR SHPËRTHIMIN NË IBËR-LEPENC, MBROJTJA KËRKON PËRJASHTIMIN E PROKURORIT

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Për shkak të kërkesës së mbrojtjes të të akuzuarve për përjashtimin e prokurorit special, Bekim Kodraliu, në Gjykatën Themelore në Prishtinë është ndërprerë të mërkurën seanca fillestare për rastin e shpërthimit në kanal in e Ibër-Lepencit. Avokati i të akuzuarit Jovan Viqentijeviq, Nebojsa Vllaiq tha se nuk ka vërejtje për trupin gjykues, por kërkoi që prokurori Kodraliu të përjashtohet nga lënda. Sipas tij, klienti i tij u arrestua më 1 dhjetor 2024 dhe vetëm gjashtë ditë pas kësaj, ka parashtruar kërkesë për mbledhjen e provave. Sipas Vllaiqit, kjo kërkesë iu dorëzua prokurorisë së shtetit dhe gjykatës dhe provat iu dorëzuan të dyja palëve. Vllaiq tha se atëbotë prokuror në këtë rast ishte Halim Borovci, ndërkaq tani është Bekim Kodraliu, duke pretenduar se nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga provat që ai i ka propozuar. “Kam propozuar që të merren video-incizimet nga dy objekte që të bisedohet më së paku me katër persona, që të bëhet analiza bazike e stacioneve telefonike. Të vërtetohet nga cilat antena telefonike në kohën kritike Jovani ka pranuar sinjale. Kjo do të tregonte se ku ka qenë. Në asnjë mënyrë nuk është vepruar sipas kësaj. Janë marrë vetëm disa incizime të një kamere dhe janë shfaqur në mënyrë shumë selektive. Nuk është treguar koha - që është shumë e rëndësishme”, tha Vllaiq. Mbrojtësi pretendoi se Kodraliu ka shkelur dispozitën e nenit 7 të Kodit të Procedurës Penale, i cili thotë se është i obliguar që me kujdes t’i vërtetojë faktet që shkojnë në dobi apo dëm të të pandehurit. Vllaiq pretendoi se provat janë humbur përgjithmonë sepse askush nuk është i obliguar që t’i ruajë incizimet për një vit, nëse nuk ka një urdhër për një



gjë të tillë. Nisur nga kjo, sipas tij, është shkelur neni i Kodit të Procedurës Penale sa i përket një procesi të drejtë dhe mbrojtje të drejtë. Të gjitha këto shkelje të pretenduara, sipas Vllaiqit, nxisin dyshime “në paanshmëri të prokurorit”. Kërkesën për përjashtimin e Kodraliut, Vllaiq tha se e ka dërguar edhe te kryeprokurori i shtetit. Ndërkaq, avokati i Dragisha Viqentijeviq, Millosh Delleviq, iu bashkëngjit kësaj kërkesë. Ai tha se ka parashtruar kërkesë te prokurori që të dëgjohen katër dëshmitarë, të mblidhen video-incizimet e kamerave nga dy objekte në Zubin Potok, të cilat pamje janë një orë para dhe një pas shpërthimit. Por, sipas Delleviq, deri sot prokurori nuk ka vepruar sipas kërkesës së tij, duke konsideruar kështu se është dëmtuar e drejta e tij për mbrojtje. Ndërkaq, mbrojtësja e të akuzuarit Igor Dimoviq, Jelena Krivokaqiq kërkoi që seanca të ndërpritet.

Megjithatë, ajo tha se nuk ka asnjë vërejtje për prokurorin. “Konsideroj që në mënyrë të pakthyeshme e ka dëmtuar të drejtën në mbrojtje të Dragisha Vishetijeviq. Përveç neneve që përmendi kolegu Vllaiq, ai ka shkelur edhe nenin 47 të KPP-së i cili parashih obligimin e prokurorit special ndaj të pandehurit. Ai nen parashih që prokurori shtetëror gjatë hetimeve t’i shqyrtojë provat dhe faktet të cilat e rëndojnë të pandehurin dhe ato që i shkojnë në dobi”, tha ai.

Kodraliu: Sulmi cenoi direkt sigurinë kombëtare

Prokurori special, Bekim Kodraliu, u shpreh se ndoshta mbrojtjes nuk i pëlqen hetimi që ka zhvilluar, por theksoi se sulmi ka qenë i përgatitur në mënyrë profesionale dhe i koordinuar në mënyrë të përsosur. Sipas tij, provat që i ka propozuar mbrojtja i ka analizuar dhe janë dëgjuar

edhe sot. Kodraliu u shpreh se komunikimet telefonike të të akuzuarit Jovan kanë qenë përmes sistemit telefonik të Serbisë dhe se u janë drejtuar autoriteteve serbe dy herë me kërkesë për bashkëpunim ndërkombëtar. Por, Kodraliu theksoi se përkundër kësaj, nuk kanë pranuar përgjigje nga ata. “Ka qenë sulm që ka cenuar direkt sigurinë kombëtare dhe në atë fazë s’kemi mund të vlerësojmë se kush është dëshmitar, kush është i dyshuar në këtë rast penal. Hetimet i kemi zhvilluar me partnerë ndërkombëtarë”, theksoi ai. Kodraliu tha se prokuroria ka vlerësuar se në këtë fazë, dëshmitarët e propozuar nga mbrojtja nuk paraqesin relevancë që do të ndihmonin në zbardhjen e këtij rasti. “Kolegu Vllaiq ka qenë edhe ish-prokuror në sistemin jugosllav dhe është njoftuar cilat janë bazat ligjore për përjashtimin e prokurorit. Më konkretisht neni 43 i KPP-së, i parashih pesë arsye të cilat mund dhe është e

obligueshme të përjashtohet prokurori”, u shpreh ai. Sipas tij, pesë arsyet janë: kur është palë e dëmtuar në proces, kur është familjar me të pandehurit apo të dëmtuarin, kur është kujdestar ligjor apo është prind i të pandehurit apo të dëmtuarit, nëse kam marr pjesë si gjyqtar në këtë proces gjyqësor dhe nëse unë si prokuror kam ndonjë konflikt interesi me këta të pandehurit - “me sa e di unë nuk kam ndonjë konflikt interesi”. Kodraliu tha se është në dorën e gjyqtarit të vendosë për ndërprerjen e seancës dhe më pas gjykatësi Vesel Ismaili vendoi që seanca të ndërpritet, derisa kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të marrë një vendim. Në seancën fillestare, që u ndërpre, të pranishëm ishin vëllezërit Viqentijeviq, ndërkaq Dimoviq po mbrohet në liri.

Për këtë rast, Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë kundër Dragisha dhe Jovan Viqentijeviqit dhe Igor Dimoviqit për veprat penale: “rrezikim i rendit kushtetues përmes shkatërrimit ose dëmtimit të instalimeve dhe pajisjeve publike”, “kryerje e aktit terrorist”, “armëmbajtje pa leje” dhe “spiunazh”. Dragisha dhe Jovan Viqentijeviq janë arrestuar pas shpërthimit më 29 nëntor 2024 dhe, që nga ajo kohë, ndodhen në paraburgim. Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë më 10 dhjetor se të dhënat e inteligjencës tregojnë se tre të akuzuarit për shpërthimin në kanal in Ibër-Lepenc kanë qenë të lidhur ngushtë me strukturat shtetërore të Serbisë. Beogradi zyrtar ka mohuar çdo lidhje me këtë shpërthim, ndërsa presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë më herët se ka disa njohuri se kush mund të jetë kryerësi, pa dhënë më shumë detaje. (REL)

Dogana mbledh mbi 1.9 miliard euro të hyra gjatë vitit 2025

Prishtinë, 24 dhjetor- Dogana e Kosovës ka bërë të ditur se viti 2025 ka qenë një vit historik për këtë institucion, duke shënuar rezultate rekord si në të hyrat buxhetore, ashtu edhe në forcimin e sigurisë dhe

mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit. Sipas të dhënave zyrtare, gjatë vitit 2025 janë mbledhur gjithsej 1 miliard e 968 milionë euro të hyra buxhetore, shifër kjo që ka tejkaluar projeksionet

fillestare dhe paraqet një rritje prej 8 për qind krahasuar me vitin paraprak. Dogana ka theksuar se një rol të rëndësishëm ka pasur edhe mbështetja për sektorin prodhues vendor dhe lehtësimi i tregtisë. Gjatë këtij

viti janë realizuar 413 milionë euro lirime doganore për prodhuesit vendorë dhe në kuadër të marrëveshjeve të tregtisë së lirë, masa këto që kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e konkurrueshmërisë dhe zhvillimin ekonomik.



Kurti: Politikat tona qeverisë kanë qenë të orientuara në investime

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Kandidati për kryeministër nga LV-ja, Albin Kurti, në tubimin elektorale në Junik ka thënë se politikat e tyre qeverisëse kanë qenë të

orientuara edhe ndaj Junikut. “Kemi ndarë afër 8 milionë euro për realizimin e rrugëve Junik-Gjeravicë, Junik-Rastavicë, rrugën unazore dhe atë që lidh qytetin me fshatrat

Jasiq e Gjocaj. Investimet kanë vijuar edhe në infrastrukturën turistike, objektin e ri të shkollës fillore, si dhe në çerdhe, kanale të ujitjes e stacionin e autobusëve. Më

28 dhjetor, votojmë 116, për më shumë investime të drejta e të duhura për Junikun e krejt Kosovën, për sigurinë dhe begatinë anekënd”, ka thënë Kurti.



HAMZA: DO TA THEMELOJMË FONDIN E PAPUNËSISË DHE GJYKATËN E PUNËS

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Kryetari dhe kandidati për kryeministër i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza ka qëndruar në Malishevë, ku ka thënë se programi i tij ofron zgjidhje reale, të llogaritura dhe të financuara qartë.

Hamza, në një tubim, në mesin e qytetarëve të Malishevës dhe përkrasësve të PDK-së atje, ka theksuar se programi i tij bazohet në katër shtylla: zhvillim ekonomik dhe mirëqenie, arsim dhe shëndetësi, drejtësi dhe mbrojtje e politikë e jashtme. Hamza ka thënë se punëtori do të jetë në qendër të politikave të qeverisë së udhëhequr nga ai, prandaj do ta themelojnë

Fondin e Papunësisë dhe Gjykatën e Punës. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve që më 28 dhjetor ta votojnë PDK-në dhe numrin 130. “Vota për PDK-në shkon në numrin 130. Kjo është adresa, nuk ka adresë tjetër. Prandaj, fitorja e PDK-së, ju gëzon juve, më gëzon mua, por të jeni të bindur që i gëzon dhe i bën krenarë Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin”, ka shtuar ai.

Tutje, kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza ka marrë pjesë në një tubim tjetër në lagjen Kalabria në Prishtinë, ku tha se bashkimi i qytetarëve rreth vizionit të PDK-së për zhvillim, stabilitet dhe mirëqenie është frymëzues.



ABDIXHIKU PËR KURTIN: AI NUK KUPTON ÇKA FLET, NDOHTA TELIN DIN ME LIDH MË MIRË AMA PËR EKONOMI S'MERR VESH



PRISHTINË, 24 DHJETOR - Kandidati për kryeministër nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se kryeministri në detyrë, Albin Kurti, nuk e

kupton çka flet.

Kreu i LDK-së në emisionin Pressing në T7 ka thënë se Kurti nuk merr vesh fare për ekonomi, por as për politikë. “Ai nuk e kupton as çka flet.

Ai më së paku kupton, jo vetëm në ekonomi, s'dua ta bëj këtë garë të padrejtë të flas për ekonomi kur kam një edukim shumë më superior në këtë fushë. Me siguri ai

për tela dhe bakër di ma mirë. Ndoshta ai di me lidh telin më mirë se unë, për ekonomi s'merr vesh ai”, ka thënë kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku.

OSBE-ja: BASHKËPUNIMI NDËR-KOMUNAL ËSHTË NJË MJET I FUQISHËM, POR PAK I SHFRYTËZUAR

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Një raport i ri tematik i OSBE-së “Bashkëpunimi Ndër-komunal në Kosovë: Mësimet e nxjerra dhe mundësitë e ardhshme” nxjerr në pah dimensionet politike, ligjore dhe praktike të bashkëpunimit ndër-komunal. “Duke u mbështetur në punën e madhe të bërë në terren, intervistat dhe konsultimet institucionale, raporti analizon pse BNK-ja mbetet pak e shfrytëzuar pavarësisht kornizës ligjore që mundëson funksionimin e saj, dhe identifikon pengesat kryesore strukturore dhe operacionale. Ky raport synon të mbështesë institucionet dhe komunat në forcimin e bashkëpunimit, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe integrimin e

bashkëpunimit ndër-komunal si një praktikë thelbësore e qeverisjes lokale efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse”, ka njoftuar OSBE-ja. “Pavarësisht këtyre përfitimeve potenciale, bashkëpunimi ndër-komunal është ende shpeshherë joformal, i pastrukturuar ose nuk ndodh fare. Si rezultat, humbasin mundësitë për shërbime më të fuqishme, shpenzime publike më efikase dhe bashkëpunim më të avancuar mes komuniteteve”, ka thënë ambasadori Gerard McGurk, Shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë.

Raporti identifikon disa mundësi kyçe për përmirësimin e BNK-së, duke përfshirë: Thjeshtimin dhe modernizimin e kornizës



ligjore për të lehtësuar themelimin e marrëveshjeve ndër-komunale. Krijimin e

stimujve politikë dhe një fondi të dedikuar për bashkëpunimin ndër-

komunal. Forcimin e mbështetjes institucionale, veçanërisht përmes rritjes së kapaciteteve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për këshillim, monitorim dhe promovim të marrëveshjeve. Promovimin e bashkëpunimit ndër-komunal në fushat e gjithëpërfshirjes, përfshirë reagimet ndaj dhunës me bazë gjinore, shërbimet për të rinjtë dhe iniciativat mes komunave me përbërje të ndryshme komunitare.

Raporti përfundon se, nëse implementohen këto reforma dhe investime, bashkëpunimi ndër-komunal mund të transformohet nga një praktikë marginale në një instrument thelbësor për përmirësimin e performancës komunale dhe forcimin e qeverisjes lokale.

Reagim nga KMDLNj

FATURAT KRIMINALE TË RRYMËS PËR MUAJIN DHJETOR

Shumë qytetarë e kanë informuar KMDLNj-në se në muajin dhjetor faturat e energjisë elektrike janë mbi 70 për qind më të larta se në muajin paraprak. Është e pabesueshme dhe e pakuptueshme një rritje aq e lartë kur temperaturat nuk dallojnë shumë në këta dy muaj andaj qytetarët nuk kanë pasur nevojë për shpenzime shtesë të energjisë elektrike. Ndërmarrja e strukturuar kriminale e quajtur ZRrE që nga themelimi i saj ka punuar në dëm të qytetarëve, paguesve të rregullt të energjisë elektrike duke ua vjedhur paratë për të mbuluar pagesën e faturave për serbët gjë që duket po e bënë edhe sot ndryshe si të arsyetohet çmimi aq i lartë për rrymë në muajin dhjetor. Ndonëse e kemi një vendim të gjykatës ku qartazi thuhet se ndërmarrja e strukturuar kriminale ZRrE në kundërshtim me ligjin fryrë faturat duke diskriminuar qytetarët në baza etnike dhe

politike, qytetarët shqiptarë dhe joserbë asnjëherë nuk janë kompensuar për dëmet që u janë bërë. Qeveria e Kosovës duke përkrahur këtë ndërmarrje të strukturuar kriminale po identifikohet si bashkëpjesëmarrëse në krim dhe varfërim të skajshëm të qytetarëve. Blerja e rrymës me çmime të larta kryesisht nga serbët dhe grekët , dyshimi për korrupsion për ambasadorin Martin Berishaj dhe ministrin kujdestare Artane Rizvanolli qartazi ndikon në çmimet e energjisë elektrike. Licencimi i operatorëve për tregti me rrymë të personave të afërt me KM kujdestar nxitë dyshime të bazuara për një korrupsion institucional të planifikuar mirë për të fituar kundërligjshëm, në dëm të qytetarit dhe shtetit. Dhënia e monopolit të tenderëve për shitblerje të rrymës në Kosovë një personi me emrin Vuk Hamoviq, serb i Serbisë, i biri i



kryeshefit të ushtrisë serbe në kohën e regjimit të Sllobodan Millosheviqit tregon se sa seriozisht po trezikohe siguria në Kosovë. KMDLNj thërret Prokurorinë e Kosovës të hetojë punën e ZRrE-së që nga fillimi i punës, dhënien e licencës monopolizuese Vuk Hamoviqit, oligarkut serb, dhënien e licencave për tregti me energji elektrike në baza nepotiste dhe politike, vendosja në vende kyçe të njerëzve të KM, largimet nga

puna shkaku i papërshtatshmërisë politike. Të hetojë të gjitha kontratat për shitblerje të energjisë elektrike KMDLNj fton qytetarët që të mbrojnë të drejtat e tyre ekonomike dhe sociale, të kundërshtojnë plaçkitjen përmes faturave jonormale të energjisë elektrike duke protestuar dhe duke pamundësuar punën e atyre që e planifikojnë vjedhjen, e kryejnë vjedhjen apo nuk e pengojnë këtë. Shfrytëzoni

përvojat e vendeve shumë më të pasura dhe më të zhvilluara se Kosova. Reagimi i tyre do të ishte i menjëhershëm dhe të gjithë keqbërësit do të largoheshin nga puna apo do të përfundonin në burg. Mungesa e një reagimi të fuqishëm qytetar po inkurajon ZRrE - në dhe keqbërësit qeveritarë që brutalisht ta dhunojnë buxhetin e familjeve kosovare duke i shtyrë në një varfëri dhe mjerim të skajshëm. Ndërmarrja e strukturuar kriminale ZRrE ka paralajmëruar se në muajin mars 2026 do të shqyrtojë kërkesën e operatorëve për rritje të çmimit të rrymës që nënkupton përkeqësim edhe më të madh të gjendjes ekonomike për pjesën dërrmuese të familjeve kosovare. Rritja e çmimit të energjisë elektrike pashmangshëm provokon rritjen e çmimeve të të gjithë artikujve dhe shërbimeve andaj qytetarët duhet ta kundërshtojnë pavarësisht se cila qeveri ka pushtetin.

UP-JA ORGANIZON PROGRAMIN ‘TRAIN-THE-TRAINER’ PËR KËSHILLIMIN DHE NDËRMJETËSIMIN NË TREGUN E PUNËS

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Universiteti i Prishtinës, në bashkëpunim me Institutin për Shkenca të Aplikuara të Këshillimit (INfaBW) nga Gjermania, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve të Kosovës, me mbështetjen e Qeverisë Gjermane përmes GIZ Kosova, ka organizuar programin intensiv “Train-the-Trainer Programme for Job Placement Counsellors”, i cili u zhvillua nga 16 deri më 20 dhjetor në ambientet e Universitetit të Prishtinës. Programi është pjesë e bashkëpunimit institucional të formalizuar nëpërmjet marrëveshjes së mirëkuptimit (MoU) ndërmjet partnerëve dhe synon ndërtimin e kapaciteteve profesionale në fushën e këshillimit për punësim, ndërmjetësimin në tregun e punës dhe shërbimeve aktive të punësimit, në përputhje me nevojat e tregut të punës në

Kosovë dhe standardet evropiane. Në ceremoninë hapëse, prorektorja për zhvillim institucional, cilësi dhe çështje studentore në Universitetin e Prishtinës, prof. asoc. Majlinda Gjellaj, theksoi rëndësinë strategjike të këtij programi për rolin shoqëror të universitetit. “Universiteti i Prishtinës po e forcon vazhdimisht lidhjen ndërmjet arsimit të lartë dhe tregut të punës. Ky program është dëshmi konkrete e angazhimit tonë për të ndërtuar kapacitete profesionale që ndikojnë drejtpërdrejt në punësueshmëri, cilësi të shërbimeve publike dhe zhvillim të qëndrueshëm institucional”, tha prorektorja Gjellaj. Ajo shtoi se përfshirja e stafit akademik dhe profesionistëve nga fusha të ndryshme e bën këtë program një platformë të rëndësishme për transferim të njohurive dhe praktikave të mira ndërkombëtare. D.sc. Vjosa Mullatahiri,



menaxhere e Komponentës Programore në Fushën e Politikave dhe Masave në Tregun e Punës, në kuadër të projektit “Fit for Jobs II” vlerësoi bashkëpunimin ndërinstitucional si faktor kyç për suksesin e programit. “Programi ‘Train-the-Trainer’ është zhvilluar duke u bazuar në nevojat e Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës, për të ngritur kapacitetet e zyrtarëve të punësimit. Programi synon të fuqizojë profesionistë të fushës për të siguruar që ky

program në të ardhmen do të ofrohet për zyrtarë e punësimit dhe të gjithë studentët tjerë që janë të interesuar të punojnë në fushën e zhvillimit të burimeve njerëzore. Partneriteti me Universitetin e Prishtinës siguron që këto kapacitete të ndërtohen mbi bazë akademike dhe profesionale të qëndrueshme”, tha ajo. Përfaqësuesi i INfaBW-së dhe ligjëruesi kryesor i programit, prof. Dr. Michael Scharpf, nga Universiteti i Shkencave të

Aplikuara për Studime të Punës, theksoi dimensionin evropian të programit. “Ky trajnim bazohet në qasje bashkëkohore të shkencave të këshillimit, menaxhimit të rasteve dhe ndërmjetësimin në punësim. Qëllimi ynë është të ndërtojmë ura funksionale mes teorisë, praktikës dhe politikave të tregut të punës”, tha Scharpf. Në program morën pjesë 15 profesionistë dhe akademikë nga Universiteti i Prishtinës, universitete të tjera, institucione publike, organizata ndërkombëtare dhe nga shoqëria civile, duke e bërë këtë trajnim një hapësirë të rëndësishme për shkëmbim përvojash dhe ndërtim rrjetesh profesionale. Ky aktivitet shënon një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të një programi të certifikuar dhe të qëndrueshëm për këshilluesit e punësimit dhe ndërmjetësimin në tregun e punës, i cili do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2026 përmes sesioneve online dhe vlerësimit përfundimtar.

Murati: 90 euro në muaj shtesat për fëmijë me qeverinë e re

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, ka folur për shtesat për fëmijë. Ai ka drejtuar akuza ndaj partive që ishin në opozitë, që sipas tij, kishin thënë se shtesat për fëmijë fillimisht nuk bëhen, sepse s’ka buxhet.

Murati ka thënë se pastaj kur u gjet buxheti dhe u bënë shtesat, opozitë thoshte që janë pak e i përqeshën si vitra, ndërkaq sipas tij, kjo opozitë tash po ofron 50 euro shtesa në muaj. Ministri në detyrë ka premtuar se qeveria e ardhshme me Kurtin do t’i

bëjë shtesat për fëmijë 90 euro në muaj. “Opozita dhe shtesat për fëmijë. Shtesat për fëmijë fillimisht thanë që nuk bëhen, sepse s’ka buxhet. Pastaj kur u gjet buxheti dhe u bënë shtesat, thanë që janë pak e i përqeshën si vitra. Tash kur i rritëm e do t’i dyfishojmë përsëri në 90 euro në muaj për

mandatin që vjen, opozita kanë filluar e po premtojnë se do t’i bëjnë shtesat nga 50 euro në muaj. Por a ka kush që u beson opozitës, të cilët për 20 vite me radhë asnjëherë nuk u kujtuan që Kosova kishte fëmijë dhe duhej mbështetur?”, ka shkruar Murati në “Facebook”.



‘IT’S A WONDERFUL LIFE’, FILMI MË EMOCIONUES I KRISHTLINDJES NË HISTORINË E KINEMATOGRAFISË



Nuk janë të shumtë filmat e mëdhenj për Krishtlindjen. Klima e festimeve të Krishtlindjes të jep më shumë ndjesinë e vetmisë të personazheve në fund tek filmi “The umbrellas of Cherbourg” dhe dritëzat dekorative e bëjnë akoma më të çuditshme aventurën erotike të protagonistit tek “Eyes Wide Shut”. Kur filmi i Krishtlindjes kërkon të jetë një ndryshim emotiv ose fetar është e zakonshme që të kthehet në tmerrësisht sentimental. Megjithatë ka një përjashtim nga ky rregull dhe është filmi i Krishtlindjes par excellence, me titull “sa bukur është të jetosh” (It’s a Wonderful Life) dhe u drejtua nga Frank Capra në 1946. Historia e këtij filmi me metrazh të gjatë filloi me një tregim të shkurtër të titulluar “dhurata më e madhe”, e shkruar nga Philip Van Doren Stern. Meqë nuk është ndonjë kushedi çfarë tregimi, argumenti kryesor (një njeri i quajtur George Bailey në një moment kur kërkon të kryejë vetëvrasje i vjen për vizitë një engjëll që i tregon se si do të ishte bota, nëse ai nuk do të kishte lindur), ishte mëse i mjaftueshëm që producentja RKO donte ta blinte për ta bërë një film të protagonizuar nga Cary Grant, i cili nuk e pranoi për arsye të axhendës dhe RKO e hoqi nga lista për ta bërë film. Në këtë mënyrë regjisor i dhe

producenti Frank Capra e bleu nga producentja të drejtat për ta shfaqur me protagonist James Stewart. Meqë Capra ishte një nga regjisorët më të njohur të momentit dhe Stewart një yll i madh, bëri që të realizonte një film shumë të kushtueshëm dhe madhështor. U xhirua një një studio gjigande e ngritur mbi një fshat të tërë, e vendosi filmin në një dimër me dëborë, ndërkohë që xhironte në mes të verës (aktorët xhironin me rroba dimërore, i nxehti ishte i padurueshëm) dhe realizoi kështu një nga filmat më të bukur amerikanë për periudhën e Krishtlindjes dhe që është një traditë e domosdoshmërisë së të

parit të tij gjatë kësaj feste. Respektoi përshtatjen e skenaristit, por i shtoi një kontekst më të sofistikuar. Si fillim i shtoi historisë origjinale se pse Bailey donte të vetëvritej dhe e vendosi ngjarjen në rrethinat amerikane. Në fakt, ky film ndoshta më së miri reflekton jetën e lagjeve amerikane me ambicie modeste dhe punë, por edhe me idenë e një filmi që të refektonte atë që quhej epika e njeriut të zakonshëm. Për të qënë më të qartë, Capra trajton një nga temat më të përsëritura në kinematografi: idenë e një klase të mesme me probleme si borxhe, një krizë dashurie ose familjare që në fund lufton një luftë heroike si një aventurier në



toka të huaja. Në fakt kjo ka qenë ideja kryesore e “It’s a Wonderful Life.” Këtu Bailey ëndërron një jetë epike, në të cilën udhëton dhe kthehet milioner dhe bën një jetë konvencionale, një baba i një familjeje që ka një biznes familjar. Zbulimi i tij përmes mënyrës se si do të ishte bota, nëse ai nuk do të kishte lindur, kjo jetë e thjeshtë që ai e beson të dështuar, kishte një heroizëm diskret, i cili mundësoi që shumë jetë të prosperonin dhe të shpëtoheshin. Kjo është arsyeja se pse gjatë shfaqjes së tij të parë në 1946 mori kritika negative që e cilësonin filmin si të thjeshtë dhe tepër sentimental. Filmi do të hakmerrej disa dekada më vonë sepse filluan ta konsideronin si tepër të sofistikuar nga ajo që dukej në pamje të parë. Në këtë situatë del që “It’s a Wonderful Life” është një kostante në jetën e Bailey-it, prirja e tij për të braktisur projektet e jetës madhështore për dashuri ose për një ndjenjë detyre. Kështu që pak nga pak humb gjërat për çdo vendim altruist ose dashuror. Në një pikë del se një nga temat kryesore të këtij filmi është kostoja e lartë e të qenit i mirë. Nuk njohim shumë filma që trajtojnë këtë temë dhe është një nga gjërat më shqetësuese. “It’s a Wonderful life” pas perdes së emotivitetit nuk duket se është shumë optimist. Të jesh i mirë

për Bailey-in nuk duket se i sjell shumë rikompesim, në mos i jep veç vështirësi. Fati nuk duket së është me George-in që në një moment mund të burgoset për një gabim të një nënpunësi. Emocioni për ta parë Bailey-n në fund të filmit mirë lind sepse në fillim regjisor i na zhyti në pusin e dëshpërimit. Ka një logjikë religjioziteti në dëshpërim. Capra, regjisor katolik, u shpreh se e realizoi këtë film sepse perceptonte një valë ateizmi në Amerikën e kohës. Ajo që na thotë Capra është që më mirë t’i besojmë Zotit për të na shpërblyer mirësinë sepse njerëzimi nuk duket se ndihmon. Kjo errësirë u pa në vitet 60 dhe nuk janë të paktë kritikët ose kineastët që ndihen të shqetësuar nga një film që supozohej të ishte një himn për jetën e Krishtlindjes. David Cronenberg, regjisor, e ka akuzuar si sadist filmin. Një herë Milan Kundera tha se veprat e mëdhaja komike nuk janë ato që bëjnë për të qeshur, por ato që gjejnë forma të reja komike. Në këtë mënyrë “It’s a Wonderful life” jo vetëm që është një film që emocionon, por edhe që krijon një formë të re emocioni, një të çuditshëm dhe intensiv, e bërë nga mrekulli, pemë Krishtlindjeje dhe me deux ex machina kaq të mëdhaja ashtu si edhe kinemaja nga e cila është realizuar ky film gjenial. / Bota.al




Rrahmani në listën e blerjeve të West Hamit

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Ylli i Kombëtares së Kosovës dhe Sparta Pragës, Albion Rrahmani është ndër emrat e përfolur, ndërsa West Ham United po shton kërkimin për një sulmues të ri në afatin kalimtar të janar. Callum Wilson është aktualisht numri nëntë më i mirë në klub, por

trajneri Nuno Espirito Santo nuk e ka nisur me sulmuesin anglez si titullar në asnjërën nga tre ndeshjet e fundit të “Çekanëve”. West Ham po i jep përparësi një sulmuesi të ri në javët e ardhshme, pasi aktualisht duket se janë të destinuar të bien nga Liga Premier këtë sezon.

Sipas mediumit të afërt me klubin londinez thewesthamway.com, West Hami po kërkon ta sjell Rrahmanin në “London Stadium” këtë dimër. Lojtari i Kombëtares së Kosovës ka shënuar 12 gola në 32 ndeshje në të gjitha garat këtë sezon dhe është vënë në

radarin e trajnerit Espirito Santo. 25-vjeçari aktualisht po luan te Sparta Praga, duke iu bashkuar atyre verën e kaluar nga Rapid Bukureshti. Është pohuar se West Ham e admiron Rrahmanin, por ende nuk ka bërë ndonjë lëvizje për ta blerë atë.



FIFA: KOSOVA, KOMBËTARJA ME NGJITJEN MË TË MADHE NË RANGLISTË GJATË VITIT 2025

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Kombëtarja e Kosovës e ka përmbyllur vitin 2025 në vendin e 80-të të ranglistës së FIFA-s, që është pozita më e mirë ndonjëherë në historinë e saj. Dardanët e nisën vitin nga vendi i 99-të dhe, me një përparim prej 18 pozitash, shënuan ngjitjen më të madhe nga të gjitha kombëtares e tjera gjatë këtij viti. Ky progres i jashtëzakonshëm dëshmon zhvillimin e vazhdueshëm të kombëtares sonë dhe rezultatet e shkëlqyeshme në arenën ndërkombëtare. FIFA e ka konfirmuar zyrtarisht Kosovën si kombëtaren me ngjitjen më të madhe të vitit në renditjen globale. “Para kualifikimeve për Kupën e Botës, Kosova kishte fituar vetëm një nga 18 ndeshjet

eliminatore dhe kishte shënuar tetë gola, duke pësuar 39. Megjithatë, kjo ndryshoi në vitin 2025. Ekipi i drejtuar nga Franco Foda, pas humbjes në xhiron e parë ndaj Zvicrës, mbeti i pamposhtur në pesë ndeshjet e tjera, fitoi tri prej tyre dhe siguroi për herë të parë një vend në ‘play-off’-in evropian”, ka shkruar FIFA pas publikimit të ranglistës së fundit të vitit. Sipas FIFA-s, fitoret dhe barazimet, të shoqëruara me paraqitje të suksesshme në Ligën e Kombeve të UEFA-s dhe në ndeshje miqësore, i sollën Kosovës 89.02 pikë, duke e ngjitur nga vendi i 99-të në vendin e 80-të, pozita më e lartë e arritur ndonjëherë. Gjatë vitit 2025, Kosova ka regjistruar suksese të



rëndësishme: avancim nga Liga C në Ligën B të Ligës së Kombeve pas fitoreve ndaj Islandës, fitore bindëse në miqësore ndaj Armenisë dhe Komoreve, reagim i

fuqishëm pas humbjes ndaj Zvicrës, me dy fitore ndaj Suedisë dhe një ndaj Sllovenisë, si dhe dy barazime ndaj Sllovenisë e Zvicrës, sigurim i vendit në “play-

off” për kualifikim në Kupën e Botës 2026. Rruga e Kosovës në ranglistën e FIFA-s ka qenë e gjatë dhe progresive që nga përfshirja e parë në korrik 2016, kur renditej në vendin e 190-të. Hyrja në top-100 u realizua në fund të vitit 2024, ndërsa viti 2025 shënoi një ngritje të pandalshme: 97-ta në prill, 95-ta në qershor, 91-ta në shtator, 84-ta në tetor dhe përfundimisht 80-ta në nëntor e dhjetor. Në muajin mars, Kombëtarja e Kosovës zhvillon ndeshjen e radhës. Një fitore ndaj Sllovakisë në Bratisllavë do ta afronte edhe më shumë drejt kualifikimit historik në Kupën e Botës, ndërsa pozita aktuale në ranglistën e FIFA-s mbetet një shpërblim dhe motivim shtesë për Dardanët.

DRITA TRIUMFON NDAJ PRISHTINËS, I AFROHET KREUT

GJILAN, 28 DHJETOR - Kampionia në fuqi, Drita ka mposhtur fituesen e Kupës, Prishtinën në ndeshjen e fundit të këtij viti në Superligën e Kosovës në futboll. Në fakt, me këtë ndeshje edhe zyrtarisht ka përfunduar stinori vjeshtor i këtij sezoni në elitën e futbollit kosovar. Drita ka triumfuar në Gjilan 2:0 ndaj Prishtinës, ndeshje kjo e mbetur e xhiros së 13-të, e që u



zhvillua të mërkurën. Futbollistët e Dritës, i kanë dhënë fund dilemës së fituesit qysh në pjesën e parë, të cilën e mbyllën me epërsi prej dy golave. Jorgo Pëllumbi ka zhblokuar rezultatin në minutën e 26-t, ndërsa Raddy Ovouka e dyfishoi atë dy minuta më vonë, dhe në të dy golat e Dritës asistues ishte mbrojtësi i krahut të djathtë, Besnik Krasniqi.

Me këtë fitore, Drita dimëron në pozitën e katërt në tabelë me 29 pikë, sa i ka edhe Dukagjinin që zë vendin e tretë. Prishtina mbetet e dyta me 30 pikë, tri më pak se Ballkani që është kampion i stinorit vjeshtor. Për Prishtinën, kjo është humbja e tretë nën drejtimin e trajnerit Afrim Toverlani, i cili në pesë ndeshje sa e ka udhëhequr ekipin deri më tani, ka edhe një fitore e një barazim.

Zidane arrin një marrëveshje në parim, merr drejtimin e Francës pas Kupës së Botës

Paris, 24 dhjetor - Një nga lojtarët më të mëdhenj të futbollit në histori, Zinedine Zidane, ka arritur një marrëveshje në parim për t’u bërë trajneri i ri i Kombëtares së Francës, por vetëm pas Kupës së Botës vitin e ardhshëm. Zidane, puna e fundit e të cilit si trajner ishte në vitin 2021, kur u largua nga Real Madridi për herë të dytë në

karrierën e tij, do të pasojë kështu Didier Deschamps në stolin e “Trikolorëve”. Si lojtar, Zidane e kishte fituar titullin botëror në vitin 1998, dhe tani do të përpiqet të arrijë të njëjtin qëllim si trajner, duke e udhëhequr brezin e ri të Francës drejt majave globale. Sipas mediumit “le10sport”, Federata Franceze e Futbollit duhet

të ngutet ta zyrtarizoj tani Zidanen, pasi Real Madridi është kthyer në garë dhe mund të ndodh ndonjë befasi e minutave të fundit. Ju kujtojmë se Deschamps është në pozicionin e trajnerit që nga viti 2012, dhe ai fitoi Kupën e Botës në vitin 2018 në Rusi, vetëm për t’u mposhtur nga Argjentina në finalen tre vjet më parë.



Prishtinë, 24 Dhjetor 2025

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „Esha Energy“ L.L.C., me numër Unik Identifikues 811955783 me adresë: Rr. „Fehmi Agani“ nr. 25/8, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 17.12.2025 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej **2.32 MW** ZK Vërrnicë, Komuna e Vushtrrisë, Republika e Kosovës.

Shoqëria „Esha Energy“ L.L.C., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej **2.32 MW** ZK Vërrnicë, Komuna e Vushtrrisë, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.5136-2/24 dt. 10.12.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Vendimi nr. 5136-3/25 të dt. 17.12.2025 për korrigjimin e Vendimit për Pëlqimin Mjedisor Nr.5136-2/24 dt. 10.12.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Vendimin 09 nr. 111/2025 të dt. 14.08.2025 të lëshuar nga Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural e Komunës së Vushtrrisë.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Numri i vrojtimit të lejes: 531/25 të datës 26.09.2025, për “Ndërtimin e Parkut Solar Esha Energy 1 me kapacitet të instaluar prej 2.32 MW, ZK Vërrnicë, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vushtrrisë.
- Vendimin 08 Nr. 640 e dt. 15.12.2025 për miratimin e plotësim-ndryshimit të Vendimit për Leje Ndërtimore me nr. vrojtimit 531/25 të dt. 26.09.2025 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vushtrrisë.
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 14186 dt. 23.10.2025 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit;
- Kontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC);
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar,
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: eshaenergyy@gmail.com, diturie.a@hotmail.com dhe LEGAL-LECENSING@ero-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.

MDynamic Solutions L.LC.

Prishtinë, 24 Dhjetor 2025

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „Mdynamic Solutions“ L.L.C., me numër Unik Identifikues 812239623 me adresë: Rr. „California“ nr. 17, Preoc, Komuna e Graçanicës, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 17.12.2025 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej **7.18 MW** ZK Vërrnicë, Komuna e Vushtrrisë, Republika e Kosovës.

Shoqëria „Mdynamic Solutions“ L.L.C., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej **7.18 MW** ZK Vërrnicë, Komuna e Vushtrrisë, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.1886-2/25 dt. 04.06.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Vendimi nr. 1889-3/25 të dt. 17.12.2025 për korrigjimin e Vendimit për Pëlqimin Mjedisor Nr.1886-2/25 dt. 04.06.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Vendimin 09 nr. 112/2025 të lëshuar nga Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rualal e Komunës së Vushtrrisë.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Numri i vrojtimit të lejes: 533/25 të datës 26.09.2025, dhe Numri i vrojtimit të lejes: 06/87 për “Ndërtimin e Parkut Solar me kapacitet të instaluar prej 7.18 MW, ZK Vërrnicë, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vushtrrisë.
- Vendimin për miratimin e plotësim-ndryshimit të Vendimit për Leje Ndërtimore me nr. vrojtimit 533/25 të dt. 26.09.2025 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vushtrrisë.
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 14188 dt. 23.10.2025 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit;
- Kontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC);
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar,
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: mdynamicsolutionslls@gmail.com, merih2579@hotmail.com dhe LEGAL-LECENSING@ero-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Blerina Haxhidauti shpall të pavlefshme dëftesën e klasës

- Leonor Osmanaj shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Gentian Muhadri nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Pjeter Bogdani” Damjan Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.

- Krenar Abrashi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit “Krenar Abrashi” B.I. me nr. Unik: 811133719.

- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greiçevci”.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, salon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “07 Green” Shpk, Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për sistemin solar fotovoltaiik me kapacitet 1.7 MW në Jabllanicë, Gjakovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 16.02.2026 në ora 10:00 në SHFMU “Dëshmorët e Kombit” në fshatin Jabllanicë të Gjakovës, do të organizohet debat publik nga “07 Green” Shpk, Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “07 Green” Shpk, Gjakovë, për Pëlqim Mjedisor, për sistemin solar fotovoltaiik me kapacitet 1.7 MW në Jabllanicë, Gjakovë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Gashi” Shpk, Pejë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për ekspolatimin e materialeve inerte, Pejë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.02.2026 në ora 10:00 në Qendra për Karrierë IAAP “Rifat Gjota” Pejë, do të organizohet debat publik nga “Gashi” Shpk, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “Gashi” Shpk, Pejë, për ekspolatimin e materialeve inerte, Pejë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me operatorin “Eco Kos” L.L.C. kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot. 25/6477/MMPHI/521/DMM për veprimtarinë: Impiant-depo për mbledhje, grumbullim, magazinim, dhe trajtim fizik të vajrave dhe yndyrave ushqimore, Milloshevë, Obiliq , organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t’u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 14.01.2026, në ora: 10:00, në hapësirat e Eco KosL.L.C, rruga e Llapit, numër 10, Milloshevë, Obiliq, do të organizohet debat publik nga operatori “Eco Kos” L.L.C. kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot. 25/6477/MMPHI/521/DMM për veprimtarinë: Impiant- depo për mbledhje, grumbullim, magazinim, dhe trajtim fizik të vajrave dhe yndyrave ushqimore, Milloshevë, Obiliq,në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

Zoom Meeting invitation - Debat Publik - Eco Kos L.L.C

10:00 - 11:00

Wed, 14 Jan 2026

Meeting ID: 601 399 3690

Passcode: fPrr0s

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPHI-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=ECO>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

“Eco Kos” L.L.C.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “KPSEG” L.L.C. me seli në Podujevë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812004670 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “KPSEG” D.O.O. od Podujeva, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812004670 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “KPSEG” L.L.C. with headquarters Podujeva, has come to the decision to quit its business: 812004670 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1904

Columbus, Georgia, USA
0.5L